

## **NJOFTIM**

### **MBI PJESËMARRJEN NË SITE VISIT (VIZITA NË TERREN) PËR PROCEDURËN KONKURUESE TË DHËNIES ME KONCESION/PPP TË AEROPORTIT TË KUKËSIT**

Bazuar në pikën 1.4. të seksionit “Udhëzime për Ofertuesit” të Dokumentave të Procedurës Konkurruese (DPK) për dhënien me Koncesion/PPP “Për aeroportin e Kukësit” është parashikuar, një Site Visit (vizita në terren) e cila do të zhvillohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim informimin e ofertuesve mbi disa detaje konkrete të projekt-idesë, objekt i procedurës konkurruese në fjalë.

MIE, informon ofertuesit e interesuar që nisja për në terren do të bëhet nga MIE (godina qendrore me adresë Rr. Abdi Toptani, nr. 1) në datën 9.11.2018, ora 7:00 (a.m).

Nga ora 7:00-7:30 do të bëhet regjistrimi i pjesëmarrësve dhe në 7.30 nisja për në terren tek Aeroporti i Kukësit.

Në përfundim të vizitës, pjesëmarrësit do të pajisen me një dokument pjesëmarrjeje, i detyrueshëm për t’u paraqitur në ofertë.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**

**Drejtoria e Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe  
Energjisë**

**Tiranë**